



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 13567/24  
Kaçanik, 11.06.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës Kaçanik, me rastin e 25 vjetorit të Ditës së Çlirimt të Kaçanikut, mbajtur më 11.06.2024 ( e martë ). Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit , me fillim pune në ora 09:00.

Nga ekzekutivi i komunës, në mbledhje morën pjesë : Kryetari i Komunës - z. Besim Ilazi , Nënkyetari i Komunës – z. Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive komunale: Zahir Doda, Qamil Stagova, Ramadush Osmani, Suhad Dullovi, Dardana Tafili-Dauti, Pranvera Loku-Zharku, Hafize Sallahu.

Të pranishëm në këtë mbledhje kanë qenë: Deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës Elmi Reçica , Rashit Qalaj.

Xhabir Zharku – Kryetar i OVL, Azem Guri – Komandat i Batalionit II.

Mbledhjen e kryesoj , Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit

**Kryesues i Kuvendit , Kemal Murseli :** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, me rastin e 25 vjetorit të Ditës Çlirimt të Kaçanikut. Në këtë mbledhje është parapa ky :

## REND PUNE

1. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
2. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi;
3. Fjalë përshëndetëse e deputetit të Parlamentit të Republikës së Kosovës, Elmi Reçica;
4. Fjala përshëndetëse e përfaqësuesve të shoqatave të daluar nga lufta UÇK-së;
5. Fjala përshëndetëse e përfaqësueseve të subjekteve politike në Kuvend.

## 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

**Kryesues i Kuvendit , Kemal Murseli :** Të nderuar, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në kordinim me Kryetarin, kemi ftuar këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës , mbledhje këto të cilat organizohen për të shënuar një ngjarje të veçantë të rëndësishme , e në kuadër të kësaj për ne Kaçanikun nuk ka ditë më të veçantë dhe më të rëndësishme se data 11 Qershori e vitit 1999. I nderuar Kryetar, të nderuar deputet Reçica, Qalaj, i nderuar Komandant Zharku, Guri, të nderuar anëtarë të Kuvendit.

Për ta futurë në kalendarin historik këtë datë, ishin përpjekjet shekullore të shumë brezave, e në veçanti lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjaku i derdhur i shumë dëshmorëve dhe martirëve , që bënë që nga ajo ditë Kaçaniku dhe Kaçanikasit të fryshtojnë lirshëm, andaj në përkujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve dhe martireve ju ftoj ti nderojmë me një minutë heshtje.

LAVDI!

Nga Historia ne kemi mësuar se populli ynë nder shekuj ka luftuar me okupatorë të ndryshëm të cilët mësynin trojet tona duke i djegur e shkatërruar , e që qellim kishin depërtimin e popullit tonë autokton nga trojet e tyre dhe sundimin këtyre trojeve, shpeshherë të mbështetura edhe nga fuqitë e mëdha të cilat në konferanca të ndryshme edhe copëtonin trojet tona. E veçanta e luftës tonë të fundit ishte se faktori ndërkombëtar kuptoi drejtë qëllimin e luftës së drejtë të UÇK-së dhe u rreshtua në krah të popullit të Kosovës për ti ndihmuar që njëherë e përgjithmonë të largojnë okupatorin nga këto troje.

Kaçaniku i lavdishëm në të gjitha etapat historike, edhe kësaj here nuk kishte si të ishte ndryshe, djemtë dhe vajzat më të mirë të Kaçanikut të prirë nga komandantet heronj Zefi e Bardhi dhe pasuesit e tyre bënë që Kaçaniku nder të parit të fryshtojë lirshëm dhe jo rastësish festojmë të parët ditën e çlirimt. Kur kujtojmë dhe shënojmë me krenari këto datash, kujtojmë edhe Luftën e lavdishme, lufte kjo e cila po tentohet të njolloset nga gjykata të padrejta, duke akuzuar padrejtësish prijësit e luftës sonë, e që dita ditës po dëshmohet se këto akuza janë të fabrikuara nga Beogradit dhe se shpejti shpresojmë se udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do festojnë bashkë me ne Lirinë e Kosovës .

25 Vite nga Çlirimi i vendit Kosova po ecën e sigurte në rrugën e saj të vendit, Kosova po ecën sigurte në rrugën e saj të zhvillimit dhe shtet-ndërtimit me përkrahjen edhe të faktorit ndërkombëtar, partneriteti me të cilët është ndërtuar me vite, dhe ruajtja e këtij partneriteti me ta është me rendësi jetike për Kosovën. Në institucionet qendrore e lokale, duhet të angazhohemi çdo ditë të krijojmë kushte më të mira dhe mirëqenie për qytetaret tanë sepse nëse dje kishim qellim çlirimin e vendit sot e kemi obligim zhvillimin dhe integrimin e këtij vendi . Në fund duke ju falënderuar të gjithëve që jeni pjesë e kësaj seance solemne me lejoni të ju urojë 11 Qershorin Ditën e Çlirimtut ju dhe gjithë qytetarëve të Kaçanikut.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi :** I nderuar Kryesues, të nderuar deputet Reçica, Qalaj, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut, të nderuara dhe shumë të respektuara familje të dëshmorëve të kombit dhe martirëve të rënë, të nderuar ushtarë e invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ndihem i privilegjuar dhe krenar që kam rastin t'ju drejtohem sot, në 25-vjetorin e Çlirimtut të Kaçanikut, ditë kjo që shënon heqjen e prangave të robërisë nga pushtuesi shekullor serb.

11 Qershor paraqet një ditë të veçantë të historisë së Kaçanikut e të Kosovës të krijuar me sakrificën sublime të popullit dhe me shpirtin e madh e human të botës së përparuar, që parandaloi një epokë të rëndë të gjenocidit e të përhumbjes e që riktheu forcën e shpresës.

Sot 25 vjet më parë, pas përballimit me sukses të kërcënimit barbar serb që synonte shfarosjen e shqiptarëve nga tokat e pronësia shekulllore, në qytetin tonë u rindez flakadani i shpresës për jetën e lirinë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, bashkë me popullin tonë martir e të papërkulur, me 11 qershor të vitit 1999, stolisën shtegun e përgjakur të historisë sonë, me ngjyrën e ndezur të triumfit.

Po sot, nderojmë luftën e shenjtë dhe sakrificën e gjithë ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkulje e përjetshme ndaj invalidëve të luftës, që nuk kursyen gjymtyrët e tyre për çlirimin e atdheut. Ndajmë respektin për prindërit tanë, vëllezërit dhe motrat tona që ishin pjesë e pandalshme e kontributit dhe sakrificës në luftën për liri. Bashkë nderojmë e kujtojmë sot të pagjeturit, të cilët edhe pas kaç shumë vitesh u mungojnë familjeve dhe Komunës së Kaçanikut. Nder e respekt i veçantë për mërgatën shqiptare që ishte infuzioni ynë kryesor ndër vite dhe burimi kryesor i ekzistencës dhe rezistencës gjatë viteve të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të dashur mërgimtar, ju si pjesë e pandashme e kombit, ju faleminderit për angazhimin në zhvillimin dhe përparimin e qytetit tonë.

Sot, 25 vite më parë mori kuptim jeta sepse mundëm vdekjen, përfundoi robëria dhe lindi liria. Po, ne ishim dhe me fat sepse si asnëherë më parë në histori, marshimit tonë drejt lirisë, i ishte bashkuar edhe bota e civilizuar prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të nderuar të pranishëm para nesh, secili kemi kujtime e ndjenja të përziera, lot, gëzim e buzëqeshje, ngase shumica nga ne kishim humbur më të dashurit tanë. Kujtojmë një përfundim të një periudhe të luftës së pabarabartë mes popullit që donte lirinë, e përfaqësuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe regjimit të egër okupues ushtarako policor serb.

Në këtë ditë festive, ne kujtojmë gjakun e derdhur për liri të dëshmorëve heronjve të kombit, nderojmë kujtimin për të gjithë martirët e rënë, kujtojmë të gjithë fëmijët e vrarë pafajësish që janë pjesa më e dhimbshme e historisë së luftës sonë.

Për të gjithë ne, kjo ditë festë nuk mund të jetë e plotë, sepse pranë nesh sot nuk janë prijësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët padrejtësish po mbahen në Hagë. E pastër e triumfuese ishte lufta e jonë, e ngjashëm do të përfundoj dhe saga e juaj çlirimtar.

Për këtë arsy, secili nga ne e kemi obligim moral e kombëtar, që historinë tonë të çmuar ta trasojmë te brezat e rinxjtë, sepse ne kemi një histori të drejtë e të pastër, një histori të lavdishme, dhe ajo asnëherë nuk do të rishkruhet.

Të nderuar të pranishëm, 25 vite më pas vendit tonë si asnëherë më parë, i duhet përkushtimi dhe angazhimi ynë, lirisë sonë ende i duhet forca jonë për ta ruajtur dhe forcuar. Kaçaniku është duke ecur përpara. Përparim e progres kemi në të gjitha fushat e jetës. Meritë kjo e të gjithë neve që për synim patëm e kemi një qytet bashkëkohor dhe të zhvilluar.

Le të punojmë, pra, me dashuri dhe me besim se e ardhmja e Komunës së Kaçanikut dhe e qytetarëve të saj do të jetë më e ndritur dhe më e begatshme.

Kaçanik, djepi i Dardanisë dhe fat e bekim i kombit shqiptar.

Urime Dita e Çlirimtë!

Lavdi dëshmorëve të kombit, respekt luftëtarëve të lirisë dhe të gjithë atyre që kontribuan për këtë ditë.

Ju faleminderit!

**z.Elmi Reçica:** I nderuar Kryetar, i nderuar Kryesues, të nderuar asambleist , koleg Qalaj, Komandant Xhabir Zharku, familjarë të dëshmorëve, invalid, veteran dhe gjithë ju të pranishëm. Jam shumë i lumtur dhe shumë i gjuar që sot jemi këtu bashk për të festuar një çerek shekull të Kaçanikut të çliruar, pa diskutim që ngjarjet më madhore qe i ka ndodh këtij vendi janë ngjarje 25 vite më herët ku janë edhe faktet historike.

Me luftën Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me dëshmorët me komandantet sepse Brigada 162 ka dhënë dy komandat , komandant Bardhin dhe komandant Zefin, që dëshmon qe ushtarët e ushtrisë çlirimtare dhe komandantët kanë qenë në prag të betejave dhe ju kanë prij luftërave për atë arsy e kanë dëshmuar qe nuk janë sikur ushtritë tjera që kanë qene te zhvilluara dhe lavdia ju takon në radhë të parë atyre, por dua të theksoj një gjë qe përpjekjet për një shtet dhe për pavaresi nuk kanë rreshtur asnjëherë andaj e respektojmë çdo punë çdo sakrificë që kanë bere qytetaret e komunës Kaçanikut dhe Kosovës. Kemi këtu bustin e Kryetarit Kaçanikut Sali Bajrës i cili për një kohë ka vendosur një kufij dhe ka përcaktuar se ku është Kosova mirëpo nuk ka mund të realizoj deri në fund, kemi pasur përpjekte te pa rreshtuara të refuzimit të shtetit serb këtu në Kosovë nuk kanë mundur didaktori Millosheoviç ta krijoj një qeveri prej 30 shqiptareve fisnik por megjithatë liria ka ardh, liria ka ardh pas luftës ushtrisë çlirimtare të Kosovës e mbështetur nga gjithë qytetaret e Kosovës. Këtu është me rëndësi të theksojmë që pas bashkëpunimit me qendrat e vendosjes ta kemi parasysh vetëm nëse e shohim foton 11 Qershoret të vitit 1999 ushtaret dhe ushtaraket Britanez s'bashku me ushtaret Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Komandant Therren e të tjerët e dëshmon ne e kem arrit lirinë me gjakun e derdhur dhe partner dhe liria shtet-ndërtimi i integrimeve mund te bëhet dhe bëhet i sigurt me partner. Kosova dhe Kaçaniku ka shumë nevoja por besoj qe nevoja kryqe aktualisht në këto rrethana në këtu kushte çfarë jemi duke jetuar dhe përfjetuar është se Kosova të jetë sa me shpejt pjesë e NATO-së dhe të jetë pjesë integruese e bashkimit evropian dhe duke e përmbyllur këtë fjalë me urimet më të përzemërtë sepse nga Kaçaniku ka filluar edhe liria e Kosovës , prej Kaçanikut ka ardhur në Ferizaj dhe qe festohet edhe dita e lirisë e Kosovës , duke ju uruar juve që po përfaqësoni Kaçanikun këtu dhe juve qe keni dhënë gjithçka mbas të moshës dhe kohës për të ardhur deri te dita e çlirimtë të Kaçanikut. Besoj që duke pasur parasysh përvojën e angazhimin përkushtimin dhe historikun që është e një çerek shekullit por për ne qe e kemi përfjetuar dhe ju qe keni qene pjesë e të gjitha atyre përfjetimeve është një datë që është ngulitur dhe do të ngulitet përfjetë ne mendje dhe në zemrat e të gjithë qytetareve të Kaçanikut. Gëzuar edhe njëherë dhashë Zoti të kem shëndet, dhashë Zoti Kaçaniku e Kosova të ecën sigurt drejt asaj qe është kërkesë nevojë dhe domosdoshmëri e Kaçanikut dhe e gjithë Kosovës .

**Azem Guri :** Fillimisht në emër të organizatës ju uroj Ditën e Çlirimtës komunës Kaçanikut dhe ne duhet të ndihem jashtëzakonisht krenar për kontributin e dhënë nder vite e nder shekuj si Gryk e Kaçanikut dhe si rrëthinë, sepse edhe me punën dhe angazhimin e në veçanti lufta e fundit e ushtrisë çlirimtare të Kosovës njësitë tona të Brigadës 162 të udhëhequr fillimisht nga Komandant Agim Bajrami - Zefi, luftuan në të gjitha zonat operative të Kosovës. Mandej ne edhe si komunë edhe si rrëthinë po edhe si Brigadë ishim akter kryesor i furnizimit me armatim të gjitha njësitet operative të Kosovës por njëkohësisht shërbymen edhe anën politike për përcjelljen e delegacionit të rëndësishme të ushtrisë çlirimtare të Kosovës që kaluan mes Grykës Kaçanikut. Për mua është ndjenjë e veçantë sepse nga 14 Maji pas ardhjes Komandant Qamil Ilazi- Bardhi, e gjithë përgjegjësia komanduese i hierarkisë ushtarake bie tek unë si Komandant i Batalonit dhe unë ndihem i nderuar dhe i privilegjuar jo vetëm në ato luftime që udhëhiqem duke fillua 21 , 25 Maj deri në fund të çlirimtës, por deri 11 Qershorit Dita e Çlirimtës që për mua

ishte privilegj dhe nder që të shkruaj raportin historik dhe të njoftoj komandën e Brigadës 162 Agim Bajrami për çlirimin e komunës të Kaçanikut. Prandaj ne të gjithë duke pasur parasysh kontributin, sakrificën si komunë si familje gjithë nenat, motrat, vëllezërët qe na strehuan e na ndihmuani për veç këtij fjalimi përcjelli urimet dhe respektin më të lartë.

Urime Dita Çlirimit e gëzofshim për vite e mote!

**z.Rrustem Zenuni :** Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë të luftës, veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar Kryetar i Komunës, e nderuar udhëheqje, të respektuar pjesëmarrës të kësaj seance Solemne.

Të nderuar të pranishëm , jemi këtu që të kujtojmë 11 Qershori e vitit 1999, ku 25 vite më parë, falë luftës të së lavdishmes UÇK-së dhe NATO-së, Kosova e fitoi lirinë nga okupatori serb. Të flasësh për përvjetor të tillë është shumë e vështirë, jo pse nuk ka çka të thuhet, por është e pa mundur që me fjalë të thuhet e gjithë sakrifica sublime e dëshmorëve të lirisë, si dhe sakrificat e mëdha te të gjithë atyre që në një apo mënyrë tjetër ishin radhitur përkrah popullit dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky vit shënon vitin e katërt me radhë qe festohet Dita Çlirimit pa kërët e kryesor të UÇK-së dhe liderët historik të historisë më të re të Kosovës

UÇK-ja e prirë nga komandanti legjendar Adem Jashari i shtohet edhe njësiti i Kaçanikut, udhëhequr nga Agim Bajrami-komendant Zefi e nga Qamil Ilazi-komendant Bardhi , ku lufta për çlirim çdo ditë po zgjerohej më shumë, por si gjithnjë në histori kur populli ishte gjendur në situata të rënda kishte lindur bijtë e vet që me gatishmërinë, vullnetin dhe sakrificën e tyre i kishin dalë zot atdheut e kjo u dëshmua edhe me luftëtarët e Brigadës 162 "Agim Bajrami", të cilët i kishin vënë vetes një mision të shenjtë, çlirimin e atdheut. Ky vend bëri shumë sakrifica e flajime për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Pushka e UÇK-së jehoi edhe këtu si në gjithë Kosovën.

U zhvilluan shumë beteja të ashpra kundër armikut. Kaçaniku i Idriz Seferit, me betejat dhe sulmet guerile, tashmë ishte bërë qëndresë heroike dhe makth për armikun, ku në përballje me armikun ranë shumë dëshmorë.

Dëshmorët na falën emrat e tyre me të cilët emërtuan rrugë, sheshe dhe institucione. Ata na falën bustet e tyre me të cilët zbukuruam sheshet dhe vulosëm përfundimisht pavarësinë e Kosovës. Ata e shtuan lavdinë në historinë tonë të lavdishme, të mbushur me dhembje dhe krenari. Të nderuar të pranishëm, lufta për liri ishte obligim, dëshmorët janë të përjetshëm, ata janë kujtesa jonë e lartë dhe nderi i kombit.

Të nderuar të pranishëm, nëse dje luftuam, sot duhet të ndërtojmë idealin e lirisë, ideal për të cilin u derdh gjak dhe u bë sakrificë ndër shekuj, por gjithmonë duke qenë të kujdesshëm ndaj familjeve të dëshmorëve e të martirëve të kombit, ndaj invalidëve të luftës e gjithë luftëtarëve të lirisë.

Sot më shumë se kurrë kemi nevojë për unitet, sepse kemi filluar të ndërtojmë shtetin tonë, të ndërtojmë institucione të forta, dhe ashtu të bashkuar të bëhem i pjesë e familjes evropiane, duke e çuar përpëra porosinë e dëshmorëve për një shtet të lirë e demokratik, për një Shqipëri etnike. Dëshmorët dhe veteranët e UÇK-së, kishin zgjedhur më të mirën për popullin, e ku ka më mirë, se t'i sjellësh lirinë e munguar ndër shekuj, ku falë kësaj lirie, ne sot jemi të zgjedhurit e popullit. E nderuara udhëheqje, dëshmorët dhe veteranët e bënë historinë, andaj ne duhet ta ruajmë dhe kultivojmë lirinë!

Urime 11 Qershori Dita e Çlirimit të Kaçanikut!

Lavdi dëshmorëve dhe gjithë të të rënëve për liri! Liria do të rrojë, aq sa do t'i kujtojmë dëshmorët!

**z.Agim Mani :** I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, i nderuar Kryetar i Komunës së Kaçanikut, Ekzekutiv, koleg asambleist, të nderuar deputet të Kosovës, të nderuar familje të dëshmorëve, shoqatat të dalura nga lufta e UÇK-së, bashkëluftëtar të UÇK-së, dhe ju gjithë të pranishmit në këtë seancë Solemne të organizuar për hirë të datës historike të 11 qershorit Dita e Çlirimtës së Kaçanikut.

Sot janë bere një çerek shekulli që Kaçaniku frymon lirshëm!

Kaluam shumë sfida, momente të trishta, të vështira dhe pas shumë vuajtjeve persekuimeve torturave, dhe maltetimeve nga okupatori serb, iu dha fundi ndryshimit të kësaj epoke të cilët u ktheyen në gjëzime pas çlirimtës së Kaçanikut dhe Kosovës.

Dita e Çlirimtës së Kaçanikut është ditë manifestimi për të kujtuar 11 qershorin e vitit 1999 kur forcat e UÇK-së hynë në qytetin e Kaçanikut.

25 vjet më parë forcat e UÇK-së ishin duke vrojtuar në periferi të qytetit, ndërsa forcat ushtarake e poliore serbe kishin filluar tërheqjen, sipas marrëveshjes së Kumanovës të arritur më 9 Qershor të vitit 1999.

UÇK-ja kontrollonte pothuajse tërë territorin e Kaçanikut, dhe me datë 11 qershor 1999 ngritën flamurin kombëtar në Kaçanik duke shpallur Kaçanikun qytet të lirë.

Ende i kam të freskëta këto kujtime të kësaj historie, Ishte një ndjenjë e pa përshkrueshme emocionale, ne patëm rastin, mundësin dhe privilegjin të jem pjesë e këtij formacioni ushtarak që të kontribojmë, sakrifikojmë si një ushtri e popullit dhe e gjithë qytetarëve të Kosovës ,dhe ta përjetojmë nga afër hyrjen e NATO-së në Kaçanik, me bashkëluftëtarët tonë të çmuar dhe ta shijojmë lirinë për herë të parë në qytetin tonë në Kaçanik.

Dhe më pas nga bazat e tyre e NATO-së në Maqedoni, kishin filluar depërtimin në Kosovë forcat tokësore të NATO-së të quajtura forcat pacheruajtëse të KFOR-it, pastaj edhe administrata e Organizatës se Kombeve të Bashkuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Në këtë moment u realizua èndrra shekulllore e popullit të Kosovës.

Falënderim dhe mirënjojje përjetë NATO-së, SHBA dhe vendeve demokratike mike, që kurorëzuan këtë aspiratë shekulllore dhe kontribuojnë edhe sot për të ndihmuar zhvillimin e pandalshëm të demokracisë, avancimit të proceseve integruese dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Ka vështirësi të shumta edhe tani, andaj ne nuk do të ndalemi se punuari ndershëm për të mirën e Kaçanikut dhe Kosovës. Sepse ky është nderimi me i madh që mund t'iu bëjmë atyre që u flijuan për çlirimin e qytetit tonë!

Sot është dita për të nderuar rezistencën dhe luftën e drejtë të Ushtirisë Çlirimtare të Kosovës, sakrificën e shumë brezave shekulllore, Komendantin legjendar, Adem Jashari dhe të gjithë martirit e kombit shqiptar kujtojmë edhe Komandantet tanë të Brigadës 162 , kujtojmë Komandantët "Agim Bajrami " dhe " Qamil ilazi".

Kosova e lirë është, faktor paqeje, stabiliteti dhe sigurie në rajon, meriton të jetë anëtare e NATO-së kjo dëshmon qartë përkrahja ndërkombëtare për liberalizimi i vizave për qytetaret e Kosovës dhe shumë të arritura tjera.

Datat si 11 Qershor, na bëjnë të reflektojmë në punën tonë të përditshme, ashtu që të mos e devijojmë rrugën të cilën e kanë trasuar dëshmorët, dhe atë për liri e bashkim.

Qytetarë të Kaçanikut, urime Dita e Çlirimtës!

**znj.Ardita Rahmani :** I nderuar Kryetar, nënkyretar ,deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës ,Kryesues, ekzekutiv, të nderuara familje të dëshmorëve, veteran, përfaqësues nga organizata të dalura nga lufta, kolege asamblistë, gjithë ju qe po na përcillni, zonja dhe zotërinj. Ushton Gryka e Kaçanikut,

Morën zjarr këta gur të malit.

E cili nga ne në këtë sallë dhe jo vetëm, rrëqethet kur e dëgjon këtë këngë e nuk i jep emocione. Cili nga ne në këtë sallë nuk e këndon me gjithë zemër këtë këngë qe na përcjellë në çdo mbledhim tonin.

Ky tekst ani pse dedikuar një epoke tjeter, kundrejt një okupatori tjeter ne fillim shekullin e kaluar – I shkon shtati edhe fund shekullit ani pse me sa e sa vite diferenca, jo veç distancë kohore por edhe ndërrim okupatori.

Në këtë 11 qershor të çerek shekullit si të lirë nga kjo foltore e Kuvendit, përveç ndjenjës e krenarisë ,uroj bashkëvendësit e mi për ditën e çlirimtë komunës tonë.

Nuk mund të le veç në kujtimet e mijë ngase jam e bindur që kanë qenë përjetime të njëjtë edhe nga bashkëmoshatarët e mijë asaj kohe 4-5 vjetarë, kur dëgjonim e shihnim prindërit e të afërmit tek përqafonin e uronin me lot njeri tjetrin për Çlirimin e Kaçanikut tonë.

Nuk mundem të e lë veç në kujtimet e mijë as rikthimin në shtëpinë tonë familjare të djegur sa me ska e që lagjëja ku jetoja ishte e tera shkrumb e hi as emocionin që bashkë me gjyshin tim ecnim shtëpisë e nga dhoma në dhomë për të pa se si okupatori serb kishte djegur djersen e ndërtimit të asaj shtëpie por s'kishte mundur kurrë të djegë kujtimet e tona në atë shtëpi.

Ata dogjën gjithçka qe gjeten para, ata vranë këdo që rezistoi për konakun e tij por ata nuk munden të vrajën shpresën dhe dashninë e një fëmije asaj kohe 4 vjeçar për ketë vend, se benë atëherë e s'do të mund ta bëjnë kurrë e kësaj dite.

Nuk mundem të le veç në kujtimet e mijë as ditën e parë në shkollë, ku gjatë prezantimeve tona të para me njeri tjetrin e kuptova se shok e shoqe klase kisha Mentorin djalin e dëshmorit Ejup Dushkaja e Xheneten vajzën e dëshmorit Selim Shehu.

Edhe ata si unë 5 vjeçar atëkohë veç se ata fëmijë dëshmorësh, dëshmorë të Republikës së Kosovës.

Sot, ata dy shok e shoqe klase me një të përbashkët mes tyre, krenarisë për prindërit dhe atdherdashurisë, jeta kishte rezervuar të ardhme të ndryshme, sot njeri në kërkim të një jete më të mirë jashtë në mërgim dhe tjetra infermiere sepse amanet i pa thëne nga baba kishte qenë dhe kuptuar nga ajo shërbimi për qytetarë.

Si një e re e këtij vendi, si një nanë qe sot tej vetes sheh të ardhmen e fëmijës, si grua qe perspektiven e jetës e sheh në Republikën e Kosovës uroj qe ky vend të bëhet me i mirë në nderim të atyre që përveç flijimit janë dhe do të mbeten krenaria jonë më e madhe kombëtare. Sot uroj dhe bëj thirrje në unitet për Republikën e Kosovës, sepse Kosova mundet të jetë edhe më e mirë.

Urime 25 vjetori i Çlirimt Jemi Kaçanik.

Hej Kaçanik o shkëmb e gur

Vritesh pritesh për Flamur,

Për Flamurin e Skenderit,

Luftojnë djemtë e Idriz o Seferit.

**z.Ekrem Livoreka** – I nderuar Kryetar, të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i nderuar Kryesues, të nderuara familje të dëshmorëve, veteran, përfaqësues nga organizata të dalura nga lufta, kolege asambleist.

Sot shënojmë 25 vjetorin Ditën e Çlirimit të Kaçanikut, kujtojmë të gjithë të rënët për lirinë e Kosovës. Luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me komandantin legjendar Adem Jasharin. Data 11 Qershori 1999, ishte kthesë për qytetin tonë, ishte ditë e çlirimit, ditë e gjëzimit. Për të ardhur deri te kjo ditë, rruga luftarake e Brigadës 162 "Agim Bajrami" ishte e gjatë dhe plotë me sakrifica, një luftë e lavdishme. Kjo luftë për të cilën është derdhur aq shumë gjak e për këtë luftë që dhanë shumë trima, shumë gra e vajza të rritura, shumë fëmijë të mbetur jetimë. Lufta që bëri UÇK-ja, është një luftë heroike dhe një luftë e drejtë, luftë për liri e pavarësi. Pa kryengritjen e armatosur të kësaj ushtrie nuk do të kishim çlirim, nuk do të kishim Kosovë të lire.

Brigada 162 "Agim Bajrami" në luftën çlirimtare ka dhënë 95 dëshmorë të lirisë në mesin e tyre edhe komandant të Brigadës 162 "Agim Bajrami" dhe "Qamil Ilazi".

Lavdi të rënëve për liri, ndër dhe respekt familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve dhe gjithë atyre që kontribuan për këtë ditë.

Gëzuar 11 Qershori Dita e Çlirimit Kaçanik!

**z.Agim Çaka** : I nderuar Kryetar, të nderuar deputet, i nderuar kryesues dhe kolegë asamblist, të nderuar përfaqësues të ekzekutivit komunal, të nderuar përfaqësues të veteranëve te UÇK-së, shumë të respektuar përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, të nderuar gjithë ju të pranishëm. Sot, këtu, nëpërmjet kësaj mbledhje solemne, po i kushtojmë vëmendje të veçantë një ditë shumë të rëndësishme për komunën tonë. Po kujtojmë dhe po e festojmë Ditën e Çlirimit, një prej ditëve dhe festave më të rëndësishme të komunës, e cila paraprin edhe çlirimin e qyteteve tjera në vazhdim dhe të Kosovës në tërësi.

Kjo ditë na kthen 25 vite mbrapa dhe na kujton ditët e tmerrshme në përballje vendimtare me pushtuesin, i cili për shumë dekada ushtronte dhunë në mënyra të ndryshme mbi popullin tonë, i cili nuk kërkonte më shumë se lirinë dhe pavarësinë për të ardhmen e tij.

Dita e Çlirimit është kurorëzimi i gjithë përpjekjeve të brezave të ndryshëm, gjyshërvë, prindërve,

motrave dhe vëllezërve tanë, të cilët në periudha të ndryshme kohore dhanë aq sa ditën dhe mundën për çlirimin e vendit. Gjyshërit tanë ishin edhe pa shkollë, edhe të uritur, por nuk e braktisën këtë vend.

Edhe prindërit tanë, pavarësisht presionit për të mos u shkolluar dhe përballjes me skamjen dhe torturën, nuk u dorëzuan, duke lindur dhe rritur neve, fëmijët e tyre, që vazhduam përpëra në dyert e fakulteteve të ndryshme për të avancuar edhe më shumë drejt ngritjes dhe forcimit të vetëdijes se ky vend është i robëruar dhe duhet të punojmë për çlirim dhe pavarësi, duke mos harruar porosinë e gjyshërvë se liria nuk është e lehtë dhe nuk falet.

Shumica prej nesh që jemi këtu jemi dëshmitarë të kohës, dëshmitarë të githçkaje që ndodhi me ne dhe brezat e asaj kohe. Shtypje, padrejtësi në të gjitha sferat e jetës, maltretimi dhe vrasje, ndjekje dhe dhunim, pasiguri në punë, në rrugë dhe në shtëpi, etiketimi dhe diferencimi, largimi nga puna, nga institucionet publike dhe largimi nga shkollat. Kjo ishte barra me të cilën ne që jetuam atëherë duhej të përballonim dhe të tejkalonim.

Dhe kështu, pas çdo ditë, që ishte më e vështirë se tjetra, nga akumulimi i zullumeve nga zullumqarët që nuk ngopeshin me zullum, lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila në radhët e

saj kishte djemtë dhe vajzat e kalitur nder breza për të rezistuar, për të luftuar dhe për të flijuar jetën për lirinë e vendit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri detyrën e saj, djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përbushen obligimin e tyre patriotik ndaj vendit, shumica prej tyre përbushën obligimin e tyre me betimin se do të luftojnë deri në fund dhe disa prej tyre përbushën obligimin me betimin se do ta japid edhe jetën e tyre për çlirimin e vendit.

Prandaj sot kemi veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj sot kemi në çdo cep të Kosovës varre të dëshmorëve, si dëshmi e pa shlyer se falë gjakut e tyre ne sot gëzojmë lirinë dhe festojmë Ditën e Çlirimit. Prandaj ne, edhe të tierët që vijnë pas nesh, jo vetëm sot, jo vetëm Ditën e Çlirimit, por çdo ditë përjetë duhet të themi respekt për çlirimtarët, lavdi për dëshmorët e kombit, mirënjojje për aleatet ndërkombëtarë të cilët na mirëkuptuan dhe na ndihmuan në luftën e drejtë për liri.

Por nuk duhet të harrojmë se lufta për të ndërtuar shtetin nuk ka përfunduar, ajo do të vazhdojë edhe për ne dhe brezat që vijnë, me punë dhe zhvillim, me shëndetësi dhe arsim të avancuar, me bujqësi të zhvilluar dhe me rininë e shëndoshë, dhe mbi të gjitha me një politike të qartë dhe të shëndoshë të sigurisë kombëtare, e cila nuk do të vë në pikëpyetje themelet e shtetit tonë të ri, të ndërtuar më shumë mund dhe sakrifica. Po e përfundoj fjalimin tim me një kërkesë të thjeshtë dhe logjike në këtë ditë të veçantë.

Le të festojmë të gjithë së bashku në këtë ditë, pa dallime politike, sepse gjaku që u derdh për liri tejkalon ngjyrat e partive. Le të bashkohemi të gjithë, sepse liria është një dhe nuk krahasohet me asgjë tjetër.

Gëzuar Ditën e Çlirimit! Të festojmë dhe të urojmë që edhe shumë breza pas nesh të festojnë ketë ditë, ndër festat më të rëndësishme në historinë e komunës tonë.

Procesmbajtës  
Mavije Murseli

